



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.430/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 9 Nëntor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.430/2025 e datës 09.11.2025.

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej dy mijë e pesëqind euro (2,500).

III. Detyrohet subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 09.11.2025 në PZAP, është parashtruar ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 08.11.2025, në oborrin e shkollës në fshatin Bajgorë, e cila është caktuar të shërbejë si qendër votimi për datën 09.11.2025, është zhvilluar një tubim elektorale nga kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës, z. Faton Peci. Gjatë këtij aktiviteti politik, kandidati dhe përfaqësues të tjerë të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kanë vendosur një tendë në hapësirat e shkollës, kanë mbajtur fjalime dhe kanë zhvilluar aktivitete elektorale pa marrë paraprakisht leje nga Komisioni Komunal Zgjedhor (KKZ) dhe pa miratimin e drejtorit të shkollës, siç parashihet me ligj. Në këtë tubim ka qenë i pranishëm edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje dhe deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, i cili ka marrë pjesë aktivisht në ngjarje, duke e bërë atë edhe më qartë një aktivitet politik të organizuar. Për këtë arsye, kërkoj nga PZAP që të shqyrtojë këtë rast me prioritet dhe, në

bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, t'i shqiptojë dënimin përkatës subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe kandidatit Faton Peci, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Provë ka bashkangjitur një CD me përmbajtje të videos.

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të datës 11.11.2025, thekson se lidhur me aktivitetin në fshatin Bajgorë, sqarojmë se ngjarja në fjalë nuk ka qenë tubim i organizuar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, por një grumbullim spontan i qytetarëve në hapësirë publike. Hapësira ku është mbajtur aktiviteti - oborri i shkollës - është një vend publik, dhe tubimi ka ndodhur pa asnjë përgatitje paraprake të fushatës elektorale, pa rekuizita, pa pajisje audio, skenografi apo elemente propagandistike. Ndonëse kanë qenë të pranishëm qytetarë që kanë përkrahur kandidatin për kryetar komune, ngjarja nuk ka qenë aktivitet fushate në kuptimin e Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024. Qytetarët kanë të drejtë të tubohen e shprehin mbështetjen e tyre politike. Edhe nëse do të konsiderohej tubim, mungon çdo element i organizimit të qëllimshëm nga subjekti, prandaj nuk mund të ngarkohet përgjegjësia politike apo ligjore mbi Lëvizjen Vetëvendosje apo kandidatin Faton Peci. Për këto arsye, ankesa e PDK-së duhet të refuzohet si e pabazuar në fakte dhe në dispozitat e ligjit.

Në përgjigje në ankesë të KQZ, të datës 12.11.2025, theksohet se sipas paragrafi 2 të nenit 4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, subjektet politike të certifikuara, mund të mbajnë tubimet në hapësirat publike, në institucionet arsimore, sportive dhe kulturore, ku nuk pengohet puna e rregullt e tyre dhe pasi që kjo lejohet nga institucioni përkatës dhe KKZ. Ndërsa, në bazë të informatave të pranuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ju njoftojmë se ky Komision nuk ka pranuar asnjë kërkesë lidhur me tubimin e përmendur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë dhe provat e bashkangjitura, gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, të cilat janë ofruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dhe përgjigjes së KQZ-së, gjen se subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, më datë 08.11.2025, në oborrin e shkollës në fshatin Bajgorë, e cila është caktuar të shërbejë si qendër votimi për datën 09.11.2025, është zhvilluar një tubim elektoral nga kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës, z. Faton Peci, pa njoftuar Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Mitrovicë, si dhe pa dorëzuar formularin për njoftim për tubim. Paneli vlerëson se ankesa është e bazuar, sepse mbajtja e tubimit elektoral pa njoftim është në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 3 i Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. sipas të cilës dispozitë: *“Subjekti politik i certifikuar që dëshiron të organizojë një tubim politik, duhet ta dorëzojë përmes email-it, formularin për njoftim për tubim në Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), shtojca I -Formulari për Tubimet Publike, jo më vonë se: 3.1. Njëzetë e katër (24) orë para kohës kur është planifikuar mbajtja e tubimit me më pak se dyqind (200) pjesëmarrës.”*

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Prandaj, Paneli vëren se mbajtja e tubimit elektoral pa paralajmërim në KKZ është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike përkatësisht, neni 4 paragrafin 3 dhe nen paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 33 pika 3 dhe 4., nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, neni 13.2 i për Procedurat e parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.430/2025, datë 12.11.2025

Kryesues i Panelit
Skender Coçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.